

## Ndjësia e të qenit i lirë mes kulturash që përplasen ADDENDA (gjërat që duhen shtuar, sepse harrohen) – tregim nga ERIS RUSI



### Letërsi

**Fjalët kyçe:** Projekti, dilemë, e panjohura, librat, biblioteka, gjuhë, liria, qyteti, imazhi, fjala, heshitja, femra, dashuria, qytetërimi, letërsi, epsh, ndjenjë, peshku.

Rovena Vata

Center for Albanological Studies, Tirana, Albania.

### Abstrakt

Rrëfimi është ndërtuar në mënyrë të tillë që ato që mendohen nga personazhi pa zë, të artikulojnë nëpërmjet zërit të rrëfimitarit. Marrëdhënia shumë e ngushtë e rrëfimitarit me personazhet bën që të ketë një shkrije mes tyre, sa rrëfimtari e humb statusin e tij të dallueshëm dhe në disa raste ka vështirësi për të kuptuar nëse po flet personazhi, apo rrëfen ai. Duke qenë se rrëfimtari është personazhi kryesor, ai fiton një pava-rësi të madhe dhe liri të shprehuri, ai herë vetërrëfen, herë bisedon me të tjerë, herë është i mbyllur në vetvete, herë na rrëfen ëndrrat, herë na rrëfen për histori që duket se s'kanë të bëjnë me të. Në fund të fundit të rrëfyerit është baras me të jetuarit, do të shprehej Todorov dhe mungesa e rrëfimit do të thotë vdekje. Ky tregim ka ekzistencë kohore dhe hapësinore si gjithçka tjetër që ekziston dhe, si i tillë, ai vendos marrëdhënie me gjithçka tjetër që e rrethon e, në mënyrë të veçantë, marrëdhënia më e rëndësishme është ajo që vendos, me lexuesin model ashtu siç shprehet Eco, ose lexuesin e nënkuptuar siç e quan Iser-i, i projektuar në mendjen e shkrimtarit gjatë krijimeve të tij. Në rastin në fjalë kujtesa vetjake e lexuesit bëhet njësh me atë të rrëfimitarit, prandaj mund të themi se fati i mirë i këtij tregimi është se është botuar pikërisht në kohën kur është shkruar. Të gjitha ato që thamë më lart, na çojnë në përfundimin, se e reja dhe e veçanta e këtij tregimi është se sjell një frymë të re dhe kjo gjë ndihmon në zhvillimin dhe rrugëtimin e letërsisë shqipe. Çdo vepër arti përpiket, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, të tregojë jetën dhe sendet ashtu siç janë në të vërtetë, por që nuk mund të kuptohen menjëherë nga gjithkush, për shkak të mjegullës së rastësive objektive e subjektive. Arti e largon këtë mjegull. Idetë janë thelbësisht intuitive e, për pasojë, të pashtershme në përcaktueshmërinë e tyre të afërt. Njohja e tyre mund të arrihet vetëm nëpërmjet rrugës së intuitës, që është ajo e artit. Kush është përfshirë, mbushur nga një ide, është shfaqësuar, në rast se zgjedh artin si mjet për ta paraqitur, shprehur idenë e tij. Të qenët dhe të ndjerit i lirë i Alvidos shihet në raport me veten dhe në raport me botën tjetër prej nga vjen dhe me atë ku pretendon të shkojë. “Nuk arriti të mendonte tjetër veç shtrëngimin e saj, që erdhi si një shkul i panjohur erërash Atlantiku, ndjeu aromën e kripur dhe shijen e lirisë të ngjyer nën diellin dhe rrebeshet tropikale të Brazilit të largët”.

### Hyrje

Gjuha është pjesë përbërëse e kulturës, ndaj faktorët relevantë të komunikimit i përkasin kulturës dhe qytetërimin, e cila mishërohet më së miri në tregim, nga citojmë:

*“Mbledhja i solli që të bëhej pjesë e një grupi kozmopolit studentësh, nga Kina dhe Japonia tek Mali i Zi, Spanja, Brazili dhe ishujt grekë të afërt, Maroku dhe toka latine, të mishëruar në figura meshkujsh e femrash që tregonin krejt tokën nga vinin dhe diellin që kishte regjur ADN-në e origjinës së tyre”.*

Në rastin kur Addenda e përshkruan Alvidon si karakter njerëzor shprehet: *“Ti je tamam si një malësor i rritur keq në qytetin e madh”*, por ajo flet edhe për raportin që kishte ai qoftë me gjuhën e tij, qoftë me gjuhët botërore dhe përdorimin e tyre si: italishten, frëngjishten, angli-shten, i thotë: *“Shqipja jote e kafshuar dhe e mbytur nga tinguj të marrë borxh, nga gjuhë të tjera që bën sikur i di! Addio, Au revoir, Bye-bye, dreqi të merr vesh”.*

Por edhe vetë Alvido e ndjen peshën e shumë gjuhëve kur shprehet: *“E ata njerëz të gjuhëve të ndryshme”*, çka nënkupton këtu jo vetëm gjuhë të ndryshme, por rrjedhimisht edhe kulturë tjetër, tradita të tjera, qytetërim tjetër, mënyrë të menduari dhe të jetuari krejt tjetër nga ajo e Alvidos. Edhe pse ai gjendej në këtë përplasje kulturash të ndryshme botërore, Alvido ishte i lirë në përfytyrimet dhe ndijimet që kishte, këtë na e thotë rrëfimtari: *“Për Alvidon ishte e thjeshtë të pranohej gjithçka që dilte nga përfytyrimet dhe ndijimet e njeriut”.*

Autori që në fillim të tregimit vendos të na njohë me perceptimin e personazhit kryesor i cili shfaq “DILEMËN” e tij të shumëfishtë në përballje me botën si:

**Kulla e Babelit:** Pra për pëshqjellimin gjuhësor dhe ngatërresën njerëzore për t'u marrë vesh me njëri-tjetrin, që në zanafillë të krijimit të tyre.

**Për mjegullnajën e identiteve:** Identiteti është i rëndësishëm për secilin nga ne, pasi është pasaportë identifikimi, duke filluar nga: gjuha, kultura, besimi, tradita etj.

**Distancën kilometrike të njerëzve:** Çka nënkupton distancën fizike dhe distancën shpirtërore, që ekziston mes qenieve njerëzore sidomos me përhapjen e globalizimit.

**Konceptin e njerëzve të mbyllur dhe të trembur:** Çka nënkupton se duke ardhur nga shtete të vogla dhe duke shkuar drejt shteteve të mëdha, këto të fundit si rrjedhim janë edhe më të hapura në lirinë individuale dhe kulturore. Njerëzit e vendeve të vogla janë të trembur, pasi vijnë nga hapësirat e ngushta të të menduarit dhe duke ecur drejt hapësirave të pafundme tremben nga e PANJOHURA.

Kemi raste që në vepra të letërsisë shqipe, shfaqet problemi i izolimit, i mbylljes në vetvete dhe si rrjedhim kjo mbyllje brenda skemave tradicionale dhe të jetuarit e të menduarit sipas kodeve të caktuara morale, ndodh për shkak të frikës nga rreziku i jashtëm.

Dilema e personazhit kryesor të tregimit, që del e nënkuptuar nga leximi i tekstit dhe jo e shprehur me fjalë, ajo shfaqet në dy forma: **dilemë personale** dhe **dilemë ekzistenciale**.

**Dilemë personale:** Që ka të bëjë me atë çfarë dua dhe çfarë më duhet.

Unë nuk kam arritur kurrë ta kuptoj, ta shpjegoj se si dy qenie që dashurohen, të sigurt në dashurinë e tyre të ndërsjellë, të cilët presin e besojnë të gjejnë në dashurinë e tyre lumturinë më të madhe, nuk parapëlqejnë të shkëputen me forcë nga të gjitha normat shoqërore, të largohen me hapa të vendosur skajorë nga të gjitha lidhjet dhe të përballojnë çdo fyerje, në vend që të heqin dorë nga jeta e kështu, edhe nga lumturia, përtej së cilës ata nuk mund të imagjinojnë gjënë më të madhe<sup>8</sup>.

*“Fillimisht ai qëndroi më këmbë e i habitur, u mat t’i afrohej e t’i hidhej në qafë, ta puthte e t’i kërkonte ta kalonin më në fund jetën, e përgjithmonë, të dy. Por nuk e bëri dot këtë. U ndje i lodhur, sikur sekrete të një jete të mëparshme, të së djeshmes së tij, të nisinin t’i kullonin si bulëza helmi mbi lë-kurë. Ajo fliste, e tashmë nuk e shihte më as në sy. Kurse Alvidoja, për herë të parë, për atë ditë, kuptoi që po i vinte fundi. Ndjeu si ishte perëndimi i njeriut, kur dalloj në refleksin e xhamit përballë, nën muzgun që po zaptonte krejt dhomën, pamjen e një djaloshi, që po kërrusej pa fund. Të kota, të turpshme, të frikshme! Fjalët!”*

**Dilemë ekzistenciale:** Që shfaqet në raport me veten dhe tjetrin dhe në raport me botën dhe vendin ku jetojmë.

**Dilema e dashurisë së Alvidos mes: Addendës** e cila e joshte nga pamja dhe sjellja, por ishte e panjohur, mes *Johannës* së mirë dhe të dashur, për të cilën besonte se një ditë do të fitonte dashurinë e saj apo mes *Estelës* me prapësitë e saj çapکہne, me flokët e prera keq si ndonjë djalë harrakat dhe me sytë e qelqtë, të gjelbër smeraldi.

Addenda ishte një vajzë me temperament mistik dhe e ashpër në veprime. Sipas Alvidos në analizën logjike përtej ndjenjës që kishte ndaj saj, ai thotë se Addenda ishte si zhurma e detit, si tërbimi i dallgëve dhe si era e acartë e veriut.

Çdo njeri, para së gjithash, parapëlqen dhe dëshiron fort, deri furishëm, individin e bukur, d.m.th atë, tek i cili karakteri i species, tërësia e karakteristikave të species është ngulitur në mënyrën më të pastër, më të papërzier.

<sup>8</sup>Arthur Schopenhauer, *Metafizika e dashurisë*, Phoenix, Tiranë, 1999, f. 13.

**Dilema ekzistenciale:** “*I erdhi ndërmend vendi i origjinës, Shqipëria e vogël e largët, qyteti i lindjes me njerëzit që vraponin çdo ditë nën trysinë e jetës pa adresë. Njëlloj si titujt e fshirë, kjo iu mungonte shtetasve të vendit të tij, adresimi, diçka që mund t’iu lexohej dhe t’iu njihej si titullare nga sytë e botës*”.

Alvido është personazh që guxon dhe do ta prekë me çdo kusht të panjohurën, por është në dilemë. Nga njëra anë koncepti i tij i të menduarit dhe i të vepruarit është i lirë, por kjo liri e tij vallë a do të mund të kuptohet nga të tjerët, nga ata që ka përballë vetes, si dhe pse nuk mundet Alvido të kuptohet nga kultura e tij????!!!.

Që në fillim lexuesi njihet me Alvidon, me konceptin e tij të të ndjerit i lirë dhe papenguar nga askush, për asgjë. Rrëfimtari e vizaton kështu konceptin e lirisë së personazhit të tij: “Për Alvidon ishte e thjeshtë të pranohej gjithçka që dilte nga përfytyrimi dhe ndijimet e njeriut. Jo se e kishte zakon të fluturonte me ëndrra të varura në tokën e absurdit, por e quante rregull të thoshte përherë po. Gjithçka bëhet. Asgjë nuk ka kufij. E përveç kësaj bindjeje të fiksuar, pati nisur të ndjente se si i forcohej trualli nën këmbë, si ia dilte të mbushte me siguri mushkëritë dhe në fjalët që lëshonte nga goja, të ndjente shijen e freskët të kënaqësisë, kontrollit dhe pushtetit”.

Në këtë përplasje kulturash dhe mendimesh e gjejmë herë pas herë personazhin kryesor të këtij tregimi.

Gjatë analizës së tij na duket si një personazh me shumë përvojë jetësore dhe që mban peshë nga e kaluara e tij dhe nga vendi që vjen.

Duhet të theksojmë faktin se Alvido është një personazh i krijuar në një tokë tjetër, në një kulturë tjetër dhe jo në atë të vendit të tij, është një personazh që vjen nga përtej detit, që mendon dhe vepron si ata që ka përreth, por që në disa raste e pengonte ADN-ja e origjinës krijuese.

Vetëm një paragraf më poshtë se fillimi i tregimit shohim se Alvido rrethohet nga libra, tregues ky që personazhi kryesor është një njeri intelektual dhe i studiuar duke kërkuar të krijojë identitetin e tij kulturor në një qytet botëror, edhe pse has në vështërsi subkulturash, por ai ishte edhe person me një status të caktuar në dobi të kulturës dhe shoqërisë, një personazh i etur për dije.

Alvido na shfaqet një person me shtresëzime kulturash dhe përplasja më e madhe e tyre bëhet brenda vetë atij. Ai në shumë raste ishte në “përplasje” me atë çfarë mendonte dhe atë çfarë vepronte, është një personazh mirëfilli intelektual i ardhur nga një shtresëzim kulturor i përzgjedhur, një personazh i lexuar dhe i formuar të cilin gjatë gjithë kohës e shoqëron dëshira për dije dhe zbulime të mendësive njerëzore.

Për këtë na vjen në ndihmë pjesa e tregimit ku ai shoqërohet gjithmonë me miqtë e tij të përjetshëm që ishin librat, me bibliotekën dhe universitetin si në rastet: “përqark kishte **libra**”, “një mori pa fund tekstesh që nuk e kishin atë shijen e zakonit të fletës së ndenjtur”, “koha sot e njihte së miri Kafkën apo Konradin fillimisht për imazhin e tij edhe pa lexuar asnjë “libër”, “aroma e **librave** dhe hijet që lëshonin përtokë tekstet nga natën përvindheshin personazhe”, “e bindën që do të shkonte si jo më mirë ai qëndrim”, “përvijoi gjatë një shtegu që e nxori te biblioteka”, “u afrua në një tavolinë e në heshtjen absolute vendosi përpara **librin** e tij”, “u ngrit nga vendi dhe shkoi në një **raft librash** të lodhur nga koha”, “të gjithë me kapakët e fshirë nga titujt”, “shfletoi faqen e parë të njerit **prej librave**, edhe ajo e bardhë”, “tashmë ishte në korridorin e gjatë të **universitetit**”, “kështu i pëlqente ta mendonte Shqipërinë para asaj faqeje të bardhë”, “e duke lodruar këtë mendim në mendje, e mori me vete **librin** të ulej sërish në vendin e tij”, “si e mbështeti **librin** në tryezë”, “hapi faqen e dytë dhe gati klithi nga kënaqësia: -Bosh edhe kjo!, por prapë faqja ngjasonte krejt e bardhë”, “**libri** i zbrazët e ai mund ta mbushte me përfytyrimin e tij, është i zhveshur”, “**libri**, -foli pa vetëdije kur ndjeu si lëvizti figura e ulur përballë”, “**libri**?-iu duk sikur foli ajo, me një lodhje të dukshme për të thënë fraza të gjata”.

Në vështrimin e parë të lind përshtypja sikur kemi të bëjmë me një tregim mirëfilli dashurie, ama kur shihet me vëmendje çdo detaj i ndërthurur brenda tekstit kuptohet se autori të prezanton me një kulturë dhe subkulturë tjetër të trajtimit të tekstit.

Alvido, një djalë rreth 30-vjeçar, na jep një tjetër imazh nga ai që jemi mësuar të ndeshemi në letërsi duke iu referuar moshës së personazhit. Alvido një djalosh i pashëm, energjik dhe i fuqishëm, me një fytyrë të hijshme që mbulohej me kaçurrela të zinj, me një buzëqeshje që i nxirrte në pah dhëmbët e bardhë dhe të rregullt, presim që të na shfaqej me sjellje dhe mendësi tjetër nga sa jemi mësuar të lexojmë. Duke qenë kështu, lexuesi pret që të shohë një personazh snob i cili do të na rrëfejë për baret, pijet, jetën e natës së qytetit apo të kryeqytetit, eksperiencat e tij me vajzat, por Alvido na paraqitet krejt ndryshe. Ai paraqitet si një personazh me personalitet dhe që i duhet të respektojë rolin e statusin që shoqëria i ka caktuar. **Duke qenë një personazh që mendon përtej të sotmes, rrjedhimisht është edhe në dilemë për të nesërmen.**

Identiteti kulturor i një vendi është më i rëndësishëm se pamja e tij gjeografike apo piktoreske; janë lidhjet e tij me letërsinë ato që kanë rëndësi, njëlloj sikur shkrimi të mos kishte të bënte përveçse me vende tashmë të shkruara<sup>9</sup>.

**Dilema kulturore e Alvidos** na jepet në nënreshta duke e shprehur atë me anë të ngjyrave gri ose ngjyrave të errëta prej të cilave kuptojmë përjetimet e tij shpirtërore dhe emocionale.

Rrëfimi i tregimit, duke qenë se realizohet nga protagonistin, fiton një ngarkesë emocionale të madhe. Ai vetëzbulohet nëpërmjet mendimeve, ndjenjave të tij, por ai na zbulon edhe të tjerët nëpërmjet marrëdhënieve që krijon me ta, ose përmes kujtimeve që i vijnë ndërmend:

*“...udhëtimet e kohëve të hershme, kalërimet e ditëve që ngjanin me diell pa perëndim, e më tej melodia e ëmbël e jetës, buzëqeshjet e kthyerë në ledhatim”.*

Në tekst flitet herë pas herë edhe për raportin që kishin dy të rinjtë mes tyre, por gjendja emocionale e Alvidos është përplot me dritë-hije: për të kuptuar këtë i referohemi tregimit kur vetë ai shprehet:

*“por kjo nuk mjaftoi që ai të **dëshpërohej**”, “si i mësoi sytë **me të errtën**”, “kaloi pëllëmbën e ngrohtë mbi lëkurën e zhveshur, **të errët**”, “lëvizti symbyllas **errësirën**”, “vështrimi i mikes së tij mori një **pamje pikëlluese**”, “duke nxituar të mbyllej në banjë e me buzët e shtrënguara, të **kafshonte mallkimin dhe dëshpërimin fatal**”.*

Shkrimtari sillet si fëmija që luan. Ai krijon një botë fantazie, të cilën e merr shumë seriozisht, në të cilën investon një ngarkesë të madhe emotive dhe e ndan atë qartësisht nga realiteti<sup>10</sup>.

Mishërimi femëror dhe feminiteti i Addendës shprehet në formën më të pastër dhe sublime, në përshkrimet fizike që ai i bën asaj. Duke iu referuar tekstit gjejmë elemente si: përshkrimet fizike në të cilat në fillim përmendet trupi (shtati) dhe pastaj emërohet me pjesët e tij si: buzët, flokët, gjoksi lakuriq, mollëzat, sytë, mesi, gjunjët, këmbët, shpatullat, kurrizi që në këtë kontekst janë përdorur në aspekt erotik.

*Kur u ndal në **buzët e Addendës**, ndjeu t'i kreshpërohej dëshira, **rrëshqiti sytë në trupin e saj, në format e përkedhelta të gjoksit**, që depërtoheshin mes një bluze të zbardhët të hapur deri në kraharor, **Trupi i saj ishte një hartë krejt e panjohur, Sytë e saj shkëlqyen**, por nuk tha asnjë fjalë, Ngjante si një sirenë e zeshkët, e hijshme dhe tunduese, me kruspullin e flokëve të dendur që i **lodronin mbi gjoks**, E menjëherë pas asaj fjale, ai*

<sup>9</sup>Micheal Foucault, *Poetika e intertekstualitetit*, Parnas, Prishtinë, 2011, f. 119.

<sup>10</sup>Sigmund Freud, *Psikanaliza e Artit dhe e Letërsisë*, Dituria, Tiranë, 2000, f. 19.

\*Shih: Zymer Neziri, *Poetika e krahasimit*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2004.

ndjeu se si shkulmi i ajërt i tij ndoqi një shteg të fshehtë drejt e në *shpatullat e Addendës*, duke lënë aty një shenjë të kuqe, që shumë shpejt u bë një njollë e vogël e zezë, pastaj u përhap me ca vija të vogla, të shpërndara në të gjithë kurrizin, Addenda, e *lëkundur nga gjunjët*, tashmë mbahej e përthyer, me duart pas divanit, me forcat e pakta për të mos u rrëzuar në dyshemenë, “Me këto *flokë që përdredhura si dreq*, të zinj pis si shpirti i djallit, me këtë buzëqeshje të pështirë që të *shtrembëron mollëzat* kur hap gojën e gajasesh me shkulme”, “pse i shijonte çdo kafshatë ajri që merrnin nga *buzët e njëri-tjetrit*”.

Më pas jepen me detaje elemente të përshkrimit të bukurisë femërore dhe elemente që janë objekt i joshjes të cilat ia ka falur natyra si: “*qafën e hollë dhe të errët*”, “*tisi i flokëve të zinj*”, “*duke hedhur mbi të tisin e zi të flokëve të dendur*”, “*e solli pranë vetes dhe i ledhatoi gjinjtë e zbuluar*”.

**Dilema e të ndjerit i lirë** kur dashuron Addendën, por edhe dilema të së panjohurës nga dashuria e saj.

Në rrugëtimin e tyre së bashku ai e sheh dashurinë si:

- **Ndjenjë e lirë:** (U ndje krejt i tërhequr nga mënyra si e kishte pranë. Nuk i pati ndodhur ndonjëherë të ndihej aq i plotë krah një njeriu me të cilin kishte folur aq pak, për të cilin dinte hiçgjë, por zemra i rrihte fort, e kur kaloi pëllëmbën e ngrohtë mbi lëkurën e zhveshur, të errët, kur ndjeu si u përdrodh nga një drithimë e lehtë krejt trupi i Addendës, e shtrëngoi pas vetes, i puthi buzët, i ledhatoi ëmbël flokët, duke i rrëshkitur dorën pas veshit, e me një pëshpërimë të lehtë e pyeti: - Do?)

- **Ndjenjë/dashuri:** (E kyçi gojën, e me vendosmëri, e tërhoqi me vete i dehur nga dëshira për të bërë dashuri nga e para. Deri sa gjithçka pat nisur të qetësohej, bulëzat u ulën dhe kur Addenda u kthye ajo e para, i qe hedhur për-sipër për të bërë dashuri. Ndërsa me Addendën, tani e dinte, sa herë që takoheshin, duhej të thoshte diçka, e kur fatkeqësia të niste ta mbulonte të gjorën me vulën e dhimbjes, ai të heshte, të priste pak, pastaj dashuri. Addenda do të sëmurej, e më vonë, prapë dashuri. Nga sipër i pat rrëshqitur këmisha e hollë që nuk e mbante mbërthyer: të mos humbin kohë kur të bënin dashuri. Nëse deri pak më parë ky kishte qenë sinjal për të bërë rishtas dashuri).

- **Ndjenjë drejt së panjohurës:** (Trupi i saj ishte një hartë krejt e panjohur).

- **Ndjenjë dilematike:** (U prek nga ajo ndjesi, dhe duke kaluar duart pas belit të Addendës, u ngjeth nga fërkimi i lehtë i qenieve të tyre, si të bëheshin një, rastësisht, e pa mundësi kthimi prapa. Tek po e lëshonte në tokë, një çast më vonë, iu bë sikur krejt drita e saj u mbulua nga tisi i një hijeje muzgët).

Me gjithë këto ndjenja euforike kur gjithësia e ndjenjave që ke kur je i dashuruar shoqëroheshin nga frika se mos e humb atë që dashuron.

- **Ndjenjë e pshndjellëse:** (Me përjashtim të aromës, që ishte e njëjta dhe ndjellëse, gjithçka tjetër dukej e vështirë tek ajo. Një vajzë e tjetërbotës, e hijshme sa krejt shtëllungat e magjishme të mjegullës së Olimpikut, që fliste një gjuhë oqeanesh e që kundërmonte e gjitha EPSH. Ndjeu e pshin a diçka ngashëruese që i depërtoi në shpirt. Ajo rrëmujë e dashur e ngrohtë, e çerdhes së e pshit rinor).

- **Ndjenjë marrëzie:** (Çudi që të dua, e marrëzi ta mendoj pa ty jetën, e di).

- **Ndjenjë magjike:** (Zot i arsyes, je krejt magji. O Zot, mrekulli, - psherëtiu Alvidoja, duke ndjerë brenda vetes gjithë turbullimin e një tërmeti që i lëkundti parvazet e shpirtit. Si me magji Addenda u kreshpërua krejt, lëvizti symbyllas errësirën dhe i ngrit në gjunjë, duke hedhur mbi tisin e zi të flokëve të dendur, ku ndjehej aroma e dëshirës).

- **Ndjënjë e çuditshme:** (*Diçka e pakuptimë ia zuri gojën dhe veç u ndje i çuditshëm dhe tërësisht i magjepsur nga lumturia*).

- **Ndjënjë pasionante:** (*Dhe u dogj në prushin e pasionit që lëshonte ankime të ëmbla. Ai dëgjonte psherëtima të paprovuara, nxitej dhe mundohej të fliste ngadalë pasionin e vet. Nëpër dhomë tani shquhej krejt pasioni i tyre*).

- **Ndjënjë misterioze:** (*Heshtja e Addendës mbarte diçka misterioze, por që e ndillte dhe e bënte ta dëshironte më tepër*).

- **Ndjënjë e zhveshur/e pastër:** (*E gjetën veten lakuriq, krah njëri-tjetrit. Kaloi i zhveshur mbi trupin e saj. E zhveshur, dukej krejt e tërhequr pas tij. Tashmë Addenda që zhveshur krejt, e me forcë i fërkohej pas trupit të tij. Oh, po, fjalët e tij e zhvishnin atë. “E poshtë”, - i psherëtiu ëmbël Alvido, ndërsa pa fuqi, por zhveshur, iu ul pranë, ta dëgjonte deri në fund historinë*).

- **Ndjënjë që të fal momentin (çastin):** (*I magjepsur nga ajo pamje, nga heshtja që bënte tronditëse dhe e mbushte me përjetim krejt çastin. E pat parë më parë si i ndryshonte lëkura, në ato çaste*).

- **Ndjënjë e lakuriqtë:** (*E gjetën veten lakuriq, krah njëri-tjetrit. Krejt lakuriqësia e saj erdhi si një verbim i dëshiruar. Qëndruan pezull mbi krejt figurën lakuriqe të Addendës, duke ngjasuar me një vesë të hollë të tejdukshme. E dashura e tij tashmë vezullonte lakuriqësinë e saj. Alvido mendoi vërtet të shihte, pas pak, si do shkruhej e vërteta mbi atë lakuriqësi. Duke përjetuar lakuriqen që e priste matanë*).

- **Ndjënjë përballë një personi të huaj:** (*E huaja, e gjitha, krejt, brenda meje!-mërmëriti ndërsa ngjiti shkallët e pallatit, i lodhur e me ndjesinë që ajo e priste brenda. Të njëjtat përfytyrime dhe ndjesi, që aq çuditshëm ngjanin të kishin jehonë në dy njerëz nga botë të ndryshme*).

- **Ndjënjë sekrete:** (*Me mendje e pat menduar që veç një sulm i tillë, do ta bënte të zbulonte më në fund, misterin e atij sekreti. U ndje i lodhur, sikur sekrete të një jetë të mëparshme, të së djeshmes së tij, të nisnin t’i kullonin si bulëza helmi mbi lëkurë*).

Raporti dashuror mes Alvidos dhe Addendës është një shkrirje mes ëndrrës dhe realitetit, mes artificiales dhe natyrës, mes tokësore dhe qiellores.

Duke qenë se sot më shumë se kurrë sundohemi nga bota e seksit, shkrirja fizike mes një mashkulli dhe një femre presupozohet edhe si zbulimi i sekreteve dhe të fshehtave që ekzistojnë mes tyre.

Nëse e vërteta e seksit duhet nxjerrë me zor nëpërmjet teknikave të rrëfimit, kjo vjen jo thjesht ngaqë ajo është e vështirë për t’u thënë ose gjendet nën peshën e ndalimeve të moralit. Më thellë akoma, kjo vjen ngaqë vetë funksionimi i seksit, në thelb, është i errët, ngaqë është në natyrën e tij të rrëshqasë dhe mekanizmat apo energjia e tij janë të nëndheshme; ngaqë pushteti i tij shkakor është pjesërisht klandestin<sup>11</sup>.

- **Ndjënjë që herë-herë edhe të tradhëton:** (*Turpet e Addendës, emrat e dashnorëve apo burrave të tradhëtuar, meskiniteti e mendimet e mefshta, prapësitë e një femre të shtyrë të mbyste në heshtje tradhëtisë e saj*).

<sup>11</sup>Michel Foucault, *Historia e seksualitetit I*, UET Press, Tiranë, 2011, f. 96.

Autori sikur do të thotë që ai thjesht po tregon faktet, ashtu siç kanë ndodhur dhe me sa i kujtohen. “S’mund të bëj më tepër, një jetë e fshehtë nuk duhet të ketë asnjë mangësi në të treguar; s’ka asgjë për të ardhur turp..., njohja e natyrës së njeriut s’mund të jetë asnjëherë e tepërt”<sup>12</sup>.

E në fund të fundit kjo është ndjenja e dashurisë, ne nuk e zgjedhim atë, por ajo na zgjedh ne.

Përplasja kulturore mes individëve të vendeve të ndryshme është reflektimi i imazheve kulturore në forma të ndryshme, edhe pse mesazhi i tyre mund të jetë i njëjtë, por përplasja kulturore është heshtja që shërbente si një formë komunikimi dhe që prodhonte në jo pak raste edhe emocione dhe mendime duke e lënë personazhin në dyshime dhe dilemë zgjedhjeje përballë imazhit të tjetrit.

Imazhi ka edhe diçka të jashtme, jo spirituale, ndonëse sidoqoftë ai u flet njerëzve përmes bukurisë<sup>13</sup>.

Në tekst imazhin e gjejmë të mirëshuar në këtë formë:

....të huaj me njëri-tjetrin; merremi vesh se flasim pak dhe **imazhet** bien furishëm mbi krejt ne..., ....çdo letërsi kishte autorët që tashmë, falë teknologjisë, qarkullonin më tepër si **simbole imazhi** se sa si përcjellës të fjalës..., të gjente **imazhet e piedestalta** të krijuesëve portugezë, e të zhbënte copëz pas copëze krejt mitin e jashtëm të tyre..., ....mund të dilnin **imazhe fatesh** dhe njerëzish që digjnin njëri-tjetrit, që vrisnin njëri-tjetrin, të mbushur me mëri të vogla, nën vorbullën e fjalëve që vringëllonin si armë të rrezikshme nga njëra anë në tjetrën..., ....të thyente imazhet plastike të njerëzve, të krijuesve, të miteve që gjallonin pa fund botën e çartur të sotme..., njerëz të pagojë e fytyra që ai donte t’iu vinte një emër, **sipër imazhit** që njihnin gjerësisht krejt bota..., ....i shkeli **syrin imazhit** të tij.....

Alvido beson dhe ka kurajo në realizimet e qëllimeve të tij kur shprehet se çdo gjë është e mundur.

Alvido është në dilemë mes asaj çfarë ka përballë dhe asaj çfarë ndjen. Përplasja e kulturave dhe qytetërimeve ndikon në disa raste edhe në vendimmarrje.

Marrëdhënia mes autorit dhe qytetit nuk realizohet vetvetiu, qyteti nga vjen me qytetin pritës na del në përplasje të kulturave, pasi qyteti i tij është qytet tradicional ose më saktë qytet në tranzicion dhe qyteti pritës është qytet i moderuar.

Letërsia dhe arti kanë aftësinë të transformojnë edhe njeriun, edhe realitetin estetik dhe simbolik që njeriu kundron, ndien, dëgjon. Mbi bazën e po atyre parimeve estetike që formohet shpirti i njeriut, krijohen edhe vlerat estetike që ai ka përballë vetes.

Na intereson letërsia që lidhet me qytetin si mënyrë e jetesës, si ndjeshmëri, mendësi, mënyrë e komunikimit dhe më thellë si ideologji e filozofi, më në fund: si kulturë qytetërimi. Mos do të thotë kjo që letërsia shqipe është provinciale për nga tematika (duke përjashtuar qytetin) dhe për nga stili, duke mbi ndërtuar modelet e ligjërimit popullor, apo për nga ndërtimi i personazhit, që vete sa më larg intelektua-litetit, duke sipërtheksuar veprimin e përditshëm? Po format e komunikimit të veçantë, gjestet, madje të folurit?<sup>14</sup>.

Në tregim shohim të shprehura disa cilësi dhe nyjetime shumë të sakta, për sa i përket botës që shprehet në tregim. Shohim që është në lojë një hapësirë eterike, ku bëjnë pjesë objektiva të natyra vetë ndryshme (diell pa perëndim, gjysmën tjetër të qiellit, toka e premtuar, tokë afrikane, Brazili i largët, erërash Atlantiku, me

<sup>12</sup>Michel Foucault, *Historia e seksualitetit I*, UET Press, Tiranë, 2011, f. 50.

<sup>13</sup>Walter Benjamin, *Iluminacione*, Korbi, Tiranë, 1998, f. 162.

<sup>14</sup>Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, *Letërsia dhe qyteti*, organizu-ar nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Departamenti i Letërsisë & Aleanca Franceze e Tiranës, Skanderbeg books, Tiranë, 2009, f. 66.

diellin mbi botë, e cila nën diellin që vidhej të çarave), që kanë ngjyra (krejt vezullimi i qiellit që flakëronte sa herë të dashurit i buzëqeshnin dhe e thërrisnin ëmbël njëri-tjetrin), tinguj (në divanin e tij ishte një mace e heshtur, lozonjare, gjysmë e zhveshur).

Në raport me qytetin dhe qytetërimin tregimi na jep paralelen mi-dis një qyteti të vogël dhe një qyteti të madh.

Si fillim qyteti është një vendbanim-vendjetimi madh, i centralizuar dhe i kufizuar, që ka një administratë dhe një strukturë furnizimi të vetën dhe që gjendet në pikën e takimit të rrugëve të komunikimit. Përjetimi i personazhit në këtë qytet jepet kështu: “Porto, qyteti që datonte 8 shekuj para Krishtit, e që tani derdhej i gjithi me jetën kozmopolite, në bulevard dhe rrugica që putheshin pingul me njëri-tjetrin si dashnorë tinëzari”, “Shqipëria e vogël e largët, qyteti i lindjes me njerëzit që vraponin çdo ditë nën trysinë e jetës pa adresë”.

Nga të gjitha këto që thamë më sipër arrijmë në përfundimin se ky lloj tregimi është më afër letërsisë së qytetit dhe largimit të saj nga dogmat tradicionale të trajtimit deri më sot. Kjo duket nga fjalori industrial, nga vetëdija qytetare, jeta publike dhe jeta private, fasada e ndritshme dhe nënqyteti i pistë, kodi qytetar dhe kanunet tradicionale, liria dhe ideologjia, lëvizja e mendimit dhe veprimet vetë.

**Peshku** - Është një tjetër element simbol i tregimit që shpreh në mënyrë të përgjithshme bukurinë dhe sipërfaqet e dukshme femërore si në rastet ku shprehemi: Ka trup të bukur si peshk, lëvzi si peshk, ose është e bukur si një sirenë e cila është në familjen e peshqeve, dhe më kryesorja në zhargonin e të folurit mashkullor mes njëri-tjetrit, kur shprehet se kishte kapur një peshk e barazvlefshme me kishte bërë për vete një femër të bukur.

Në shumë mitologji të lashta peshku është simbol i natyrës femërore. Ai do të thotë pjellori dhe krijim të pasardhësve, mishëron forcën e ujërave dhe aftësitë e tyre të ngjallin dhe të ruajnë jetën. Peshku lidhet me Perëndeshën-nënë. Jo rastësisht në traditën e lashtë greke ai është atribut i Perëndeshës së dashurisë Afërdita. Më vonë krishterimi afirmon peshkun si simbol të Krishtit dhe i të krishterëve të parë, që quheshin në mënyrë alegorike gjahtarë të shpirtave. Në përfytyrimet tradicionale dhe në folklorin e bullgarëve peshku gjithashtu ka vendin e vet si lloj kafshe, ushqim specifik, si objekt i sigurimit të bukës së gojës, por edhe si një figurë simbolike që ka ruajtur kuptimet e lashta mitologjike. Për shkak të mungesës së kushteve të përshtatshme të ruajtjes, në të kaluarën peshku është konsideruar si ushqim i rrezikshëm i cili lehtë mund të prishet. Peshku ka thënë: *piqmë mirë sa të zbardhen sytë e mi, në rast të kundërt mund të zbardhen sytë e tu!* – d.m.th. në qoftë se peshku nuk është pjekur mirë, njeriu mund të lëndohet.

**Pasqyra** - Identifikimi i personalitetit të personazhit kryesor. Me të drejtë Umberto Eco thekson se pasqyra reflekton të djathtën pikërisht ku është e djathta dhe të majtën ku është e majta. I referohemi tekstit kur rrëfimtari shkruan:

*“- Tek e fundit, - mendonte, - ne po shndërrohemi në pasqyra të vetvetes. Shohim nga jashtë refleksin e një fytyre të njohur, por që nuk na thotë gjë. E kjo na kënaq, për sa kohë gjithçka është së jashtmi, e largët, e huaj, që s’na zotëron”.*

**Këmisha e hollë** - Që nënkupton këmishën e natës i cili është element i pastër erotizmi, citojmë:

*“Nga sipër i pat rrëshqitur këshilla e hollë që nuk e mbante mbërthyer”.*

**ADDENDA** - Është emër simbolik, për të treguar që harresën dhe kujtesën i ndan një fije e hollë, ndaj edhe gjërat duhen shkruar sepse harrohen, Addenda është gjithashtu kulturë tjetër, gjuhë tjetër, qytetërim tjetër,



ngjyrë lëkure tjetër nga e personazhit kryesor, femër që të than buzët, por nuk të jep ndjesinë e etjes. Ajo është e panjohur për Alvidon dhe ai nuk dinte asgjë për atë, këta të dy i bashkon ndjenja për njëri-tjetrin, por jo njohja ndër vite, madje Alvido shprehet:

*“Një ditë në mëngjes nuk e kishte gjetur në shtrat. As në universitet, kur kishte pyetur për të. Madje herën që kërkoi të dinte më shumë rreth origjinës së Addendës, vetë profesoresha Fatima i tregoi që student si ajo vinin dhe iknin gjithmonë nga kurset e saj, shfrytëzonin një liri studimi që gëzohej veç nga student brazilianë, si folës të gjuhës portugeze që ishin”.*

Te një mendje gjeniale dukuria e botës valëzon, në kuptimin objektiv të fjalës, si një gjë e huaj, si një objekt për t’u soditur, që përjashton vullnetin nga vetëdija<sup>15</sup>.

Nëpërmjet personazheve simbolike si Addenda, Fatima, Alvido si dhe me pikëpyetjet sa estetike dhe emocionale apo edhe filozofike që dalin nga goja e rrëfimitarit, i cili vihet në ndihmë të personazheve që e çojnë përpara idenë, autori realizon qëllimin e tij për misterin e dashurisë së afërt dhe shmang lakminë për dashurinë e largët, utopinë vetë-shkatërruese.

**EROSI** - Si ndjenja më e pastër shpirtërore, ky eros i shprehur në formën më elegante, pa asnjë banalitet ose vulgaritet.

**Heshtja** - Fjala është argjend, por heshtja është flori. Kjo duket edhe nga përdorimi i shpeshtë që kanë në tregim togfjalëshat: *“Heshtja ab-solute”*, *“Heshtja dhe gjestet e përthyerë mes tyre”*, *“Heshtja e Adden-dës mbartte diçka misterioze”*, *“ I magjepsur nga ajo pamje, nga heshtja që bënte tronditëse”*, *“Priti në heshtje”*, *“Kishte diçka magjepsëse në krejt këtë heshtje”*, *“Pushoi pak, e si duk që në dhomë sundoi heshtja”*.

**Zhvirgjërimi** - Në këtë tregim nuk ka kuptimin e parë të fjalës, pasi zhvirgjërimi më i madh i qenieve njerëzore nuk është ai fizik, por zhvirgjërimi me FJALË.

Komunikimi është ndërveprim që mund ta ndryshojë botën, ai zbulon virtytet e veset e personalitetit, andaj psikolinguistika është njëra nga shkencat themelore të studimit të komunikimit<sup>16</sup>.

Kemi të bëjmë me personazh aktiv që nuk humbet, ai mbetet vazhdimisht vetvetja, bëhet më i pjekur, më i emancipuar, ai rritet gjithmonë si njeri<sup>17</sup>.

**Hapësira** ku zhvillohen ngjarja është Portugalia dhe arsyeja e gjendjes së Alvidos në atë vend ishte realizimi i një projekti, ndërsa çdo rrëfim është i lidhur pashmangshmërisht me kohën, që mund të ndiqet në mënyrë objektive ose mund të bëhet krejtësisht subjektive e ti nënshtrohet plotësisht shkrimtarit, duke u shndërruar në figurë.

**Koha** kur ndodhin ngjarjet është e papërcaktuar, por rrëfimtari në lidhje me kohën thotë se KALENDARI NUK FAL.

**Si përfundim** mund të themi se krejt narracioni ofron një dyzim të ndjesive, dëshirave, perceptimeve dhe pranëvënies imazh-botë e brendshme (kultura përmes fjalës). Rrjedha e rrëfimit mban ritmin e shpalosjes së një dashurie të mistershme, aq sa duket sikur vetë prota-gonistët ndonjëherë nuk e kuptojnë si gjenden në një shtrat të përbashkët. Kjo, na jep idenë e një fytyre të heshtur, apo të reflektimit lozonjar që mund të ketë dashuria, kur jo gjithmonë je në dijeni të gjërave që ndodhin, apo i paraprijnë rrethanat që përshpejtojnë ngjarjet.

<sup>15</sup>Arthur Schopenhauer, *Metafizika e dashurisë*, Phoenix, Tiranë, 1999, f. 101.

<sup>16</sup>Hasan Mujaj, *Kultura e komunikimit*, Shoqata e Intelektualëve, Jakova, Gjako-va, 2014, f. 26.

<sup>17</sup>Erich Fromm, *Dashuria për jetën*, Tiranë, 2006, f. 64.

Pra mendja nuk flet, është shpirti që drejton trupin. Addenda në vend që të konkretizohet dhe të fuqizojë lidhjen me Alvidon, nga koha në kohë, sa vjen dhe zhbëhet duke u copëzuar në përfytyrimin e protagonistit. Ajo zbulon diçka, pa dashjen e saj, ose Alvido e kupton cili është misteri që fshihet në këtë lidhje të çuditshme.

Zbulimi i sekretit të Addendës e vendos Alvidon përballë udhëkryqit: T'i nënshtrohet vullnetit të zemrës apo të mendjes. A do t'i qëndrojë Alvido mendimit se “Gjithçka bëhet. Asgjë nuk ka kufij”???!!!!.....

## Bibliografia

1. Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, “Letërsia dhe qyteti”, organizuar nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Departamenti i Le-tërsisë & Aleanca Franceze e Tiranës, Skanderbeg books, Tiranë, 2009.
2. Aristoteli, “Poetika”, Buzuku, Prishtinë, 1998.
3. Barti Roland, “Aventura semiologjike”, Rilindja, Prishtinë, 1975.
4. Benjamin Walter, “Iluminacione”, Korbi, Tiranë, 1998.
5. Burke Peter, “Kultura popullore në evropë në fillimet e kohës së re”, Arbri, Tiranë, 1996.
6. Çapriqi Basri, “Simboli dhe rivalët e tij”, Kosova Pec Center, Prishtinë, 2005.
7. Eco Umberto, “Forma e indeterminazione nelle poetiche contemporanee”, Bompiani, Milano, 2000.
8. Eco Umberto, “Gjashtë shëtitje në pyjet e tregimtarisë”, Dituria, Tiranë, 2007.
9. Ferber Michaela, “A Dictionary of Literary Symbols”, Cambridge University Press, New York, 1999.
10. Fernand Braudel, “Grammaire des civilisations”, Les Editions Arthaud, Paris, 1987.
11. Foucault Micheal, “Historia e seksualitetit 1”, UET Press, Tiranë, 2011.
12. Foucault, Micheal, “Poetika e intertekstualitetit”, Parnas, Prishtinë, 2011.
13. Freud Sigmund, “Psikanaliza e Artit dhe e Letërsisë”, Dituria, Tiranë, 2000.
14. Freud Sigmund, “Teoria e psikanalizës”, Dritan Tirana, Tiranë, 2003.
15. Freud Sigmund, “Uni dhe esi”, Dituria, Tiranë, 1991.
16. Freud Sigmund, “Veprimet e gabuara”, Fan Noli, Tiranë, 1997.
17. From Erich, “Gjuha e harruar”, Dituria, Tiranë, 1998.
18. From Erich, “Psikoanaliza dhe jeta”, Plejad, Tiranë, 2002.
19. Fromm Erich, “Dashuria për jetën”, Tiranë, 2006.
20. Gros Nathalie Piégay, “Introduction à l'interxualité”, Dunod, Paris, 1996.
21. Karl Grimberg, “Historia botërore dhe qytetërimi 1”, Uegen, Tiranë, 2003.
22. Krasniqi Bajram, “Kode të ligjërit letrar”, Rilindja, Prishtinë, 1988.
23. Krasniqi Nysret, “Epistêmë letrare”, AIKD, 2010.
24. Mujaj Hasan, “Kultura e komunikimit”, Shoqata e Intelektualëve, Jako-va, Gjakova, 2014.
25. Neziri Zymer, “Poetika e krahasimit”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2004.
26. Nietzsche Friedrich, “Ecce Homo (Si bëhet njeriu ai që është)”, Uegen, Tiranë, 2005.
27. Schopenhauer Arthur, “Metafizika e dashurisë”, Phoenix, Tiranë, 1999.
28. Todorov Tzvetan, “Poetika e prozës”, Shtëpia e librit, Tiranë, 2000.
29. Zherar Zhenet, “Figurat”, Rilindja, Prishtinë, 1985.